



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

AGJENSIA KULTURE ARSIM SPORT

Programi Vjetor i Aktiviteteve për Sektorin e Kulturës. Viti 2018

MUAJI	AKTIVITETI	PËRSHKRIMI
JANAR	PROMOVIM LIBRASH	“Takim me Letërsinë” Promovimi I Romanit të shkrimtarit Namik Dokle, “Lulet e Skajbotës”. Mbas vënies në skenën e Pallatit të Kulturës të disa monodramave të autorit dhe promovimit të romanit të pare, promovohet dhe romani i dytë.
SHKURT	Koncert I Grupit Folklorik	“Buqetë Vallesh Shqipëtare” Koncert I Grupit te Valleve, me performancë të valleve të zonës, Shqipërisë së mesme dhe veriut.
MARS	Koncert Artistik	“ Urojmë Nën at dhe Mësuesit”, koncert me poezi për këto festa , këngë dhe valle. Bashkëpunim me të gjitha shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të Bashkisë.
PRILL	Pjesë Teatrale KONCERT I FJALËS ARTISTIKE	“Magjia e Fjalës” Teatër edukativ për fëmijë, me libret të një shkrimtari të zonës, me aktorë protagoniste, nxënës të shkollave 9 vjeçare dhe kopshteve të Bashkisë, në bashkëpunim me Organizatën për Mirëqenien e Fëmijëve World Vision WV, 4000 fëmije përfitues. “Heronjtë nuk Vdesin” Koncert me rastin e 550 vjetorin e vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut, dhe emërimit të një rruge të bashkisë “17 Janari”. Koncert I fjalës artistike, poezi, këngë dhe valle.
MAJ	Përkujtim Festival Ndërkombetar	“Dëshmorët nuk Harrohen” Koncert me rastin e Ditës së Dëshmorëve, bashkëpunim me Organizatën e Veteranëve dhe Organizatën e Dëshmorëve të Atdheut. Festivali Ndërkombëtar I Monodramës “ALBAMONO” Edicioni I 15. Festivali Ndërkombëtar i Monodramës, në të cilin marin pjesë aktorë dhe stafe artistësh nga shumë vënde të Europës e më gjërë, përveç konkurimit artistik ka në vëmendje dhe njohjen e të huajve pjesëmarrës me atraksionet turistike, kulinare, dhe tradicionale folklorike dhe mundësitë që ofron rajoni në këtë drejtim. Festivali do të ngrejë siparin e fillimit të tij, në pikën turistike Pylli i Fazanëve, dhe do të vazhdojë në Katedralja, Pazari i Vjetër, Dyqani i Rrakos, Voskopojë Dardhë, Drilonë etj. Ky Festivali në 5 vitet e fundit është ekskluziviteti i

		Bashkisë Maliq nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Bashkisë si President I Festivalit, dhe Ministrisë së Kulturës.
QERSHOR	Manifestim Kulturor	“Gëzim Fëmijnor” Aktivitete kulturore dhe sportive në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë me kopshtet dhe shkollat 9 vjeçare, organizimi I kërcimit aerobik masiv të të gjitha grupmoshave në stadiumin e qytetit. Në Bashkëpunim me WV.
	Përkujtim	Krijimi I Çetës Partizane të Malit të Thatë. Koncert Letrar dhe Artistik, recitime, Këngë, Valle. Përshëndetjet me këtë rast.
	Përkujtim	Krijimi I Çetës Partizane të Gorë-Oparit. Koncert Letrar dhe Artistik, Recitime Këngë Valle. Përshëndetjet me këtë rast.
KORRIK	Dramë	“Mertrazh Pand” Dramë Ruse nga autori Vampillov, në skenë amatorët aktorë të Pallatit të Kulturës, me regji të Dhimitër Orgockës Mjeshtër I Madh. Shfaqe në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë dhe në Bashkitë e Qarkut.
GUSHT	Feste	“Buka e re” Festa në Njësinë Administrative Libonik, Koncerte Artistike, banorët pjesë aktive e shfaqes, ekspozimi I Prodhimeve të Stinës së Verës të Njesisë, Çmime për fermerët më të mire
SHTATOR	Panair	“TE FESTOJME SE BASHKU” Panairi i Embëlsirave, Prodhimeve Bujqesore Blegtorale dhe Bletërritësve në edicionin e saj të 11 në muajin Shtator në Qytetin e Maliqit me pjesëmarrjen e të gjitha Njësite Administrative. Këtë edicion do të ketë risi dhe panairin e punimeve artizanale, e cila do ti shërbejë në të ardhmen vetëpunësimit të grave dhe tërheqjes së turistëve nëpërmjet ekspozimit të punimeve me dorë.
TETOR	Promovime	Takim I Shkrimtarëve dhe Artistëve të Bashkisë dhe atyre me origjinë nga Bashkia jonë për të promovuar vlerat tradicionale në letërsi dhe art të trevës tone. Promovimi I librave të rinj të shkrimtarëve të Bashkisë , Miljana Liço, Qazim Muska, Ilir Koro. Dokumentar për jetën dhe veprimtarinë e poetit lirik të zonës Koçi Petriti. Konkurs letrar me të rinjtë e shkollave të mesme dhe 9 vjeçare të Bashkisë dhe dhenia e çmimit “Koçi Petriti”, për krijuesin e ri me të mire.
NENTOR	Teatër Komedi	“Big Bradher” Komedi nga Gurali Spahillari, autor I zonës, në skenë amatorët aktorë të Pallatit të Kulturës, me regji të Dhimitër Orgockës

	Koncert I Fjales Artistike	Mjeshtër I Madh. Shfaqje në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë dhe në Bashkitë e Qarkut. Koncert me rastin e 28 dhe 29 Nëntorit. Në bashkëpunim me Organizatën e Veteranëve dhe Organizatën e Dëshmorëve të Atdheut.
DHJETOR	Festë Festë	“Ndriçojmë Festat” Koncert në sheshin e qytetit pranë Bredhit të Vitit të Ri, me rastin e ndezjes të dritave dekoruese të qytetit nga Kryetari I Bashkisë. “ 103 Yjet e Bashkisë” Takim me nxënësit ekselentë të të gjitha Shkollave të Mesme dhe 9 vjeçare të Bashkisë, koncert me pjesëmarjen e nxënësve të shkollave, ndarja e dhuratave nga Kryetari dhe nga të ftuarit. Bashkëpunim me Kishën Ungjillore dhe Organizatën WV

Drejtori I Agjensisë

Kulturë Arsim Sport

Festim Tomorri